



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, nenit 17 dhe nenit 40, paragrafi 2, shkronja **j** e Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 18 të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal nr. 04/L-010 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 07/2011), nenit 6 të Rregullores për procedurën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 22.12.2023, merr këtë

V E N D I M
PËR NISMËN E BASHKËPUNIMIT KOMUNAL NDËRKOMBËTAR

1. Miratohet nisma e Kryetarit të Kryeqytetit për të hyrë në bashkëpunim komunal ndërkombëtar.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, binjakëzimi do të zhvillohet ndërmjet komunave si në vijim:
 - 2.1. Kryeqytetit të Republikës së Kosovës – Prishtinës.
 - 2.2. Kryeqytetit Kuwait City.
3. Autorizohet Kryetari i Kryeqytetit që të fillojë konsultimet me komunën e cekur si në pikën 2 të këtij Vendimi, për përgatitjen dhe nënshkrimin e propozim-marrëveshjes për themelimin e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, respektivisht binjakëzimin e qyteteve.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit dhe drejtoritë tjera relevante.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-020/04-236516/23, më 26.12.2023

KRYESUES I KUVENDIT
Pëllumb Bajcinovci

